

Turizmi fetar

Ndër vlerat më të spikatura të historisë dhe të kulturës shqiptare është bashkjetesa ndërfetare. E tillë shpaloet ajo edhe në Qarkun e Lezhës, i cili ka një strukturë religjioze, ku rreth 72% e popullsisë janë të besimit katolik, 25% janë të besimit myslyman dhe 3% të besimeve të ndryshme.

Nuk ekziston asnjë rast i konflikteve mes besimeve. Respekti reciprok për njëri-tjetrin është shembullor.

Në atlasin e objekteve të kultit, kemi katër lloje prej tyre:

**Kishën katolike,
kishën ortodokse,
xhaminë ,
teqen.**

Ky atlas , është i pasur me objekte mjaft të moçme të krishtërimit të hershëm në Shqipëri.



Historiku i kishës katolike ka mbartur dy momente ë rëndësishme nëpër 15 shekuj të veprimitarisë së vet.

Ajo ka përjetuar rënien gjatë shekullit të parë të pushtimit osman dhe rënien e dytë gjatë dimrit ateist të vitit 1967.

Ky dimër, nuk rrafshoi vetëm kishat katolike e ortodokse, por të gjithë objektet e kultit në Shqipëri. Këto objekte u kthyen në të ashtuquajturat shtëpi kulture, por jo rradhë edhe në depo për ekonomitë bujqësore. Disa prej tyre u kthyen në rrënoja.

Objektet u shembën, por asnjë herë nuk u shemb besimi te Zoti.

Në vitim 1990, shteti i diktaturës komuniste e lejoi besimin fetar, të cilin e kishte ndaluar me kushtetutë. Epoka e ndryshimeve të mëdha e viteve 90, hapja e Shqipërisë drejt perëndimit e ringjalli besimin dhe bëri që mbi rrënojat e objekteve të kultit të ngrihen katedrale e kisha ,teqe e xhami.

Kisha e Shen Ndout në Laç të Kurbinit , është qendra me madhe e pelegrinazhit religjioz në mbarë trojet shqiptare.Mbi një million pelegrin të gjitha besimeve vijnë në këtë kishë mrekullishë në çdo vit.



Dioqezat e Sapës, e Lezhës si dhe Dioqeza e Mirditës ,e cila pasoi Abacinë e Oroshit, kanë vlera me interes për tu vizituar.